

VENDIM
Nr.336, datë 23.6.2000

PËR DISA SHTESA NË VENDIMIN NR.199, DATË 22.4.1999, TË KËSHILLIT TË
MINISTRAVE, “PËR RRITJEN E PAGAVE TË PUNONJËSVE TË INSTITUCIONEVE
BUXHETORE”

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 6, pika 2, të ligjit nr.8487, datë 12.5.1999, “Për kompetencat për caktimin e pagave të punës”, nenit 2, pika 4, të ligjit nr.8456, datë 11.2.1999, “Për funksionimin e përfaqësuesit ligjor pranë organizatave ndërkombëtare për të drejtat e njeriut”, dhe të nenit 18, të ligjit nr.8549, datë 11.11.1999, “Për statusin e nëpunësit civil”, me propozimin e ministrit të Punëve të Jashtme, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

Në vendimin nr.199, datë 22.4.1999, të Këshillit të Ministrave, bëhen këto shtesa:

Në lidhjen nr.1, në fund të pikës B2, shtohen emërtimet:

“- Përfaqësues ligjor pranë organizmave ndërkombëtare për të drejtat e njeriut.

- Përfaqësuesi i zyrës së minoriteteve.”.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Ilir Meta